

Ditari Natyres

"Ky botim është bërë i mundur nga një grant i REC Shqipëri në kuadër të programit SENIOR-A
"Mbështetje për Organizatat Mjedisore të Shoqërisë Civile në Shqipëri". Ky program është financuar nga Qeveria Suedeze"
Nr. 19 Viti i dytë i botimit Dhjetor 2014

Në këtë numër do të gjeni:

- Parqet e Harkut Dinarik në Shqipëri, rrezultatet dhe sfidat në të ardhmen
- Plani i Menaxhimit për ZMD Porto Palermo
- Qyteti i Një mbi Një Dritareve i bashkohet nismës Shqipëria JO Duhanit
- Ligatina e Tushemishtit me infrastrukture të re
- Praktika të kompostimit
- Njoftime

Parqet e Harkut Dinarik në Shqipëri, rrezultatet dhe sfidat në të ardhmen

Tiranë 5/11/2014 - Përfaqësues të Ministrisë së Mjedisit, ekspertë të turizmit, specialistë të Zonave të Mbrojtura dhe drejtues të qeverisjes lokale u mbledhën në një takim informues për prezantimin e rezultateve të projektit "Parqet e Harkut Dinarik" në

Shqipëri. Projekti filloi punën në muajin Tetor 2013 dhe u vu në zbatim nga organizata ndërkombëtare WWF në bashkëpunim me INCA (Instituti i Ruajtjes së Natyrës në Shqipëri) dhe Ministrinë e Mjedisit. Analiza e rezultateve u shtri në katër komponentë kryesorë: rrjeti i bashkëpunimit rajonal, komunikimi me publikun, vlerësimi i përfitimeve nga ZM si dhe zhvillimi i turizmit të qëndrueshëm.

Vijon në faqe 2



Organizatat partnere të Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës



SHOQATA MJEDISORE ÇALUP
Bashkëjeto me Natyrën



QENDRA RAJONALE E MJEDISIT
Shqipëri



Mbështetje për Organizatat Mjedisore
të Shoqërisë Civile në Shqipëri



SWEDEN

Vijon nga faqe 1

Projekti i Parqeve Dinarike mbështeti krijimin e organizatës shqiptare të specialistëve të zonave të mbrojtura, një rrjet që bashkëpunon me kolegët e rajonit të Ballkanit Perëndimor, për menaxhim më të mirë të parqeve si dhe për promovimin e destinacionit të përbashkët – Parqet Dinarike. Duke përdorur një metodologji vlerësimi, ekspertët e WWF grumbulluan të dhëna shumëplanëshe në nivel kombëtar e lokal që do të mund të përdoren në përpilimet e planeve menaxhuese nga institucionet qendrore e lokale. Nga analiza e të dhënave rezulton se parqet kombëtare kanë një rëndësi specifike në zhvillimin ekonomik të turizmit dhe ekonomive rurale, furnizimin e popullatës me ujë të pijshëm, sigurimin e energjisë përmes lëndës drusore, prodhimin blegtoral, etj.

Projekti i erdhi në ndihmë sektorit në rritje të turizmit të natyrës, me anë të publikimit dhe shpërndarjes së një broshure dy gjuhëshe për destinacionet e natyrës shqiptare. Mbi 12.000 broshura promovuese u shpërndanë në pikat kufitare të hyrjes, në parqet kombëtare dhe në agjencitë e operatorëve turistikë. Promovimi i trashëgimisë së zonave të mbrojtura synon jo vetëm ruajtjen e pasurive natyrore por dhe zhvillimin ekonomik të komuniteteve që jetojnë pranë këtyre zonave. Aktualisht WWF po mbështet procesin e aplikimit të Parkut Kombëtar Lugina e Valbonës pranë Federatës

Europiane të Parqeve, si dhe përgatitjen e strategjise së turizmit të qëndrueshëm për zonën. Kjo do ta bëjë Valbonën parkun e parë në Shqipëri, ku turizmi zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme.

Z. Leon Kebe, menaxher i projektit rajonal tha në fjalën e tij se “Jemi të kënaqur të ndajmë sot me grupet e ndryshme të interesit, rezultatet e punës sonë në Shqipëri. Qëllimi ynë është të mbështesim specialistët shqiptare drejt menaxhimit efektiv të ZM, por në kushtet kur specialistët shqiptare nuk ushtrojnë detyrën e tyre në territorin e ZM, është tepër e vështirë të flasim për mbështetje, menaxhim apo arritje në sektorin e mbrojtjes së natyrës. Në vijim WWF po planifikon të punojë në projekte të zhvillimit të qëndrueshëm në disa ZM, në mënyrë që të kuptohet se mbrojtja e natyrës nuk është një dizavantazh për zhvillimin ekonomik të komuniteteve, përkundrazi është një mundësi e shkëlqyer drejt përmirësimit të jetës së banorëve lokale”.

Puna e nisur në vitin 2013 për ngritjen e rrjetit kombëtar të parqeve vijon tashme me dy projekte të tjera. Projektin vijim i WWF në Shqipëri synon zhvillimin e një plan-menaxhimi të turizmit të qëndrueshëm në Parkun Kombëtar Detar të Karaburun-Sazanit ndërsa tjetri, ndërgjegjësimin e vendimmarrësve mbi rreziqet e ndërtimit të hidrocentraleve, si i vetmi burim energjie për vendin.

Prezantohet Draft Plani i menaxhimit për ZMD të Porto Palermos

Himarë, 12 Nëntor 2014 — U zhvillua në Himarë



takimi me grupet e interesit me qëllim prezantimin e draftit final të Planit të

Menaxhimit të zonës së Porto Palermos.

Shoqata mjedisore “Adriatiku” pjesë e Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës organizoi në bashkëpunim me INCA-n dhe Bashkinë Himarë, takimin me temë “Prezantimi dhe diskutimi i draftit final të Planit të

Menaxhimit për zonën e propozuar si Zonë të Mbrojtur Detare të Porto Palermos”.

Ky takim u zhvillua në kuadër të programit “Mbështetje për Organizatat e Shoqërisë Civile në fushën e Mjedisit në Shqipëri (SENiOR-A)” me asistencë të Qendrës Rajonale të Mjedisit - REC dhe financim të Ambasadës Suedeze.

Zona e Porto Palermos është një nga zonat me vlera natyrore, kulturore dhe turistike më me rëndësi e cila ka nevojë për një status të vecantë për të gjitha ato vlera dhe vecori që mbart. Pjesëmarrja e të gjithë aktorëve kombëtar dhe lokal si dhe e të gjithë grupeve të interesit të kësaj zone shërbeu për një diskutim sa më të plotë, më frytëdhënës dhe një proces vendimmarrës e gjithëpërfshirës.

Qyteti i Një mbi Një Dritareve i bashkohet nismës Shqipëria JO Duhanit

Berat 22/11/2014 - U organizua në Berat takimi i tretë “Shqipëria Jo Duhanit!” – pas atij të Tiranës dhe Korçës, ku ishte i pranishëm



edhe Ministri i Shëndetësisë z. Ilir Beqaj, Kryebashkiaku z. Fadil Nasufi, deputetë përfaqësues në Kuvend të Rrethit të Beratit, drejtues të tjerë të lartë të sistemit të kujdesit shëndetësor në vend, përfaqësues të shoqatave dhe aktorëve të shoqërisë civile, qytetarë dhe aktivistë të Beratit.



Takimi dhe aktivitetet e tjera të Nismës [#ShqipëriaJoDuhanit](#) u organizuan nga një grup nismëtarësh të shoqërisë civile me mbështetjen e Ministrisë së Shëndetësisë, të cilat synojnë rritjen e shkallës së ndërgjegjësimit të opinioit publik për zbatimin e ndryshimeve që kanë hyrë rishtazi në fuqi në Ligjin për Mbrojtjen e Shëndetit nga Produktet e Duhanit.



Ligatina e Tushemishtit me infrastructure të re

Tushemisht, 24/10/2014 — Projekti rajonal “Ruajtja dhe Përdorimi i Qëndrueshëm i Biodiversitetit në tre liqenet e Prespës, Ohrit dhe Shkodrës” (CSBL) i financuar nga Ministria

Federale për Bashkëpunimin Ekonomik dhe Zhvillim e Gjermanisë dhe zbatuar nga Shoqëria Gjermane për



Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) në Shqipëri, i ka akorduar komunës Buçimas një fond prej 61,000 Euro për marrjen e masave mbrojtëse dhe restauruese në një nga ligatinat më të njohura në vend, atë të Tushemishtit.

Marreveshja financiare mes projektit të GIZ dhe Komunës Buçimas firmosur në Dhjetor 2012, ndërmjet të tjerash ka mbështetur njësinë e qeverisjes

vendore si dhe partnerët e tjerë lokalë kryesisht në restaurimin e burimit ujor (lumi i Kullës) që lidh fshatin e Tushemishtit me burimet e Drilonit, duke përmirësuar infrastrukturën.

Tashmë ligatina ka një urë lidhëse, një pikë vrotimi si dhe një Qender të Gjelber duke e shndërruar atë në një pikë tërheqëse për të gjithë vizitorët. Qendra e Gjelbër do të shërbejë për të informuar vizitorët dhe për të rritur ndërgjegjësimin qytetar lidhur me pasurinë e biodiversitetit të liqenit të Ohrit dhe ligatinës së Tushemishtit.



Prespës dhe Ohrit janë pjesë e Rezervës Ndërkufitare të Biosferës, shpallur pak ditë më parë në Korçë. Burimet e Drilonit, të cilat gëzojnë dhe

Vijon nga faqe 3 statusin e Monumentit të Natyrës si dhe ligatina rreth tij, ndodhen në qendër të kësaj Reserve Biosfere.

Ndërrhyrja në ligatinën e Tushemishtit, ka konsistuar edhe në organizimin e një fushate të gjërë ndërgjegjësimi mbi rëndësinë e ligatinave në përdorimin e qëndrueshëm të biodiversitetit. Kjo fushatë është organizuar edhe me bashkëpunimin e Institutit për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri (INCA) i cili ka siguruar eksperiencën dhe asistencën e nevojshme teknike dhe shkencore për realizimin e aktiviteteve të kësaj fushate.

Një mbështetje e veçantë i është dhënë nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje edhe Sekretariatit të Ohrit.

Për më shumë se dy vjet, projekti CSBL ka mbështetur vendet ndërkufitare të tre liqeneve për të mbrojtur burimet e biodiversitetit në katër fusha kresyore:

- Monitorimin e Florës dhe Faunës në perputhje me Direktivat Europiane të Habitave (Natura 2000)
- Monitorimin e Peshkut dhe menaxhimin e

peshkimit, përfshirë vendosjen e kuotave

- Mbrojtjen dhe restaurimin e ligatinave
- Karakterizimin e liqeneve dhe përcaktimin e objektivave mjedisore sipas kërkesave të Direktives Europiane Kuadër të Ujit.

Faza e dyte e mbështetjes së GIZ në Shqipëri nëpërmjet projektit CSBL nis në fund të këtij viti dhe do të përfshijë përsëri tre vendet kufitare në pjesën e liqeneve, Maqedoninë dhe Malin e Zi.

Të pranishëm në përrurimin e masave restauruese në Ligatinën e Tushemishtit ishin zv/ministrja e Mjedisit znj. Djana Bejko, zv/ambasadorja e Republikës Federale të Gjermanisë në Shqipëri znj. Anke Holstein, Drejtori i GIZ për Shqipërinë z. Hans -Juergen Cassens, prefekti i Qarkut Korçë z. Ardit Konomi si dhe përfaqësues nga Ministria e Mjedisit, akademikë, përfaqësues të Njësive të Qeverisjes Vendore dhe përfaqësues të OJF-ve që veprojnë në fushën e mjedisit.

Nga
GIZ Albania

Praktika të kompostimit

Startoi në Dajç të Shkodrës projekti pilot: “**Praktika të kompostimit**” me takimin e zhvilluar në ambjentet e Qendrës Komunitare në Shirq. Projekti zbatohet nga Milieukontakt Shqipëri dhe mbështetet nga programi për

Decentralizimin dhe Zhvillimin Lokal (dldp).

Projekti po zbatohet në bashkëpunimin me Komunën e Dajçit si vazhdim i procesit të hartimit të dokumentit “Axxhenda e Gjellbër”. Në këtë kontekst Komuna e Dajçit rikonfirmoi vullnetin për të nisur një projekt të ri në futjen e konceptit modern të kompostimit duke nxitur fermerët lokalë për të përqafuar

praktikat më të mira, si pjesë e zhvillimit të përgjithshëm të menaxhimit të mbeturinave ndër – komunale në mënyrë që të maksimizohen burimet dhe përfitimet.

Të pranishëm në takim ishin Kryetari i Komunës Dajç, përfaqësuesi i programit dldp, specialistët e zonës, ekspertë të fushës, biznese, etj të cilët diskutuan së bashku për situatën aktuale të mbetjeve organike dhe

traditat e kompostimit në të shkuarën por edhe në ditët e sotme. Me vlerë ishin sygjërimet e specialistëve mbi



Vijon në faqe 5

Vijon nga faqe 2 mënyrën e organizimit të kompostimit, trajtimit, marketimin shoqëruar kjo me stimulimin dhe ndërgjegjësimin e komunitetit për përqafimin e kësaj teknike. Një aspekt të veçantë, siç u shpreh dhe kryetari i Komunës Dajç, z. Arben Gjuraraj duhet ti kushtohet në këtë proces integritetit të shtresave në nevojë.

Kjo iniciativë, risi për Dajcin, por edhe për Shqipërinë, synon ndërtimin e praktikave të

kompostimit në nivel fermeri, futjen e këtij procesi në skemën e menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane, hartimin e tarifave të diferencuara të mbetjeve, duke i dhënë mundësi komunës të ndërtoj jo vetëm një praktikë të qëndrueshme por të shërbej edhe si një eksperiencë positive për komunat e tjera.

Nga

Milieukontakt Shqipëri



NJOFTIME

- 1- Në kuadër të projektit “Ruajtja e Pelikanit Dalmatian dhe programit të menaxhimit të ligatinave në Mesedhe-Karavasta, Shqipëri”, jeni të lutur të gjeni draftin e planit të menaxhimit të mbetjeve për Lagunën e Karavastasë.

Ky plan i mbetjeve do të jetë i disponueshëm për të gjithë ata që dëshirojnë të sugjerojnë dhe të bëjnë komente me qëllimin përmirësimin dhe rishkrimin e tij deri në datën 15 Dhjetor 2014.

<http://www.inca-al.org/index.php/sq/component/k2/item/357-solid-waste-management-plan-of-divjaka-karavasta-national-park>

Udhëzime për të kontribuar në Ditarin e Natyrës

- Rrjeti i Organizatave për Mbrojtjen e Natyrës mirëpret artikuj të ndryshëm të cilët ju dëshironi ti publikoni në ditarin e saj elektronik. Artikujt duhet të jenë jo më shumë se 150 - 200 fjalë. Ju lutemi të merrni në konsideratë këtë kërkesë, pasi interesi për të shpërndarë artikuj, lajme apo njoftime të ndryshme përmes ditarit, mund të jetë i konsiderueshëm dhe ne do të përpiqemi për të siguruar hapësirë për të gjithë ju që dëshironi të kontribuoni. Redaksia mban të drejtën për të shkurtuar apo modifikuar (jo tjetërsuar) tekstin nëse do të jetë e nevojshme.

Ju lutemi dërgoni një foto shoqëruese për artikullin tuaj dhe / ose web - link për referencë të mëtejshme.

Faleminderit për marrjen në konsideratë të këtyre udhëzimeve!

- Ky botim u mundësua nga një grant i dhënë nga Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) Shqipëri përmes programit SENiOR-A. Ky publikim paraqet pikëpamjet e autorit/autorëve mbi këtë temë. Këto pikëpamje nuk janë adoptuar apo aprovuar nga REC Shqipëri dhe nuk duhet të shihen si qëndrime të tij apo të Ambasadës Suedeze në Shqipëri. REC Shqipëri nuk garanton saktësinë e të dhënave të këtij publikimi e nuk mban përgjegjësi për përdorimin e tij.

Botim i Rrjetit të Organizatave për Mbrojtjen e Natyrës
Redaksia: Ilirjan Qirjazi; Genti Kromidha; Vilma Kadiu; Marinela Mitro

Rr. Islam Alla, Pall IVEA, Kati I, Tiranë; Tel/Fax: + 355 4 2231 437
www.inca-al.org; info@inca-al.org; www.facebook.com/inca.albania